

## Udhëzuesi për Marrdhëniet e Gjyqësorit me Median, UMGJM

---

DRAFT ...DRAFT...DRAFT

! DOKUMENT PUNE, I HAPUR PER INPUTE NGA PARTNERET !

## **Motivimi ligjor dhe praktika ndërkombëtare.**

Nuk mjafton që Drejtësia të bëhet; ajo duhet të shihet teksa bëhet! Transparenca dhe kuptueshmëria e veprimtarisë gjyqësore janë vlera të cilat burojnë nga karakteri demokratik i sistemit ligjor. Komunikimi i hapur i gjykatave me median dhe transparenca e gjykatave me publikun ndërton besimin tek gjyqësori dhe i shërben edukimit ligjor të qytetarëve.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, gjykatat kanë detyrim ligjor të lehtësojë ndërveprimin me Median (ligj (115/2016)). Për këtë qëllim janë dizenuar role të reja, sikurse janë gjyqtarët e medias (neni 91 i ligjit 115/2016), të cilët do të ndihmohen nga nëpunësit e marrëdhënieve me median dhe publikun (NMMP) për të pëmbushur sa më mirë funksionin e ri ligjor. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli.

Këshilli i Lartë Gjyqësor orienton dhe mbështet mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun. KLGJ ka detyrimin ligjor të miratojë dhe përditësojë, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, udhëzuesit standard të shtypit<sup>1</sup>. Aktualisht, KLGJ ka miratuar Planin Strategjik të Komunikimit Gjyqësor, me parashikime konkrete për gjyqtarët e media dhe rolin e tyre.

Udhëzuesi standard i shtypit, përveçse një detyrim ligjor, frymëzohet nga bindja që transparenca e gjyqësorit nuk bie ndesh me natyrën e përmbajtur të funksionit<sup>2</sup>. Një gjyqësor i hapur ndaj medias dhe publikut rrit besimin tek drejtësia, forcon pavarësinë e vet dhe rrit autoritetin e vet në kuadër të Shtetit të së Drejtës.

Udhëzuesi standard i shtypit, i mundëson shërbimet e marrëdhënieve me publikun të gjykatave të informojnë në mënyrë korrekte dhe të standartizuar median dhe përmes saj publikun mbi veprimtaritë e gjykatës si dhe për çështje të caktuara gjyqësore.<sup>3</sup>

Komunikimi i gjykatave/gjyqësorit me publikun zhvillohet gjithashtu në respekt të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por edhe të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Ky Udhëzues merr përsipër të integrojë kërkesat specifike të këtyre dy ligjeve, duke harmonizuar të drejtën për informim të publikut me mbrojtjen dhe dinjitetin njerëzor dhe të dhënave personale.

---

<sup>1</sup> Neni 91, shkronja ç), e ligjit nr. 115/2016; paragrafi 1, neni 46 I ligjit 98/2016

<sup>2</sup> Rekomandimi (2010)12

<sup>3</sup> Neni 46 i ligjit 98/2016

Miratimi i udhëzuesit standard të Medias është në përputhje edhe me stadartet ndërkombëtare<sup>4</sup>. Paragrafi 19 të Rekomandimit Rec (2010) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, miratuar më 17 nëntor 2010, thekson se: *“Procedurat dhe çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë janë me interes publik...Zëdhënësit e gjykatave ose themelimi i shërbimeve të shtypit dhe të komunikimit janë në përgjegjësinë e gjykatave ose nën këshillat gjyqësorë apo nën autoritete të tjera të pavarura është i inkurajuar. **Gjyqtarët duhet të jenë të përmbytur në marrëdhëniet e tyre me mediat.**”*

Magna Karta të gjyqtarëve, e miratuar më 17 nëntor 2010 nga Këshilli Këshillimor i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), nënvizon në paragrafin 14 se: *“Drejtësia duhet të jetë transparente dhe informacioni duhet të publikohet në funksionimin e sistemit gjyqësor.”*

ENCJ (Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin), në raportin "Besimi publik dhe imazhi i drejtësisë - Raporti 2017-2018", miratuar në Lisbonë më 1 qershor 2018, rekomandoi hartimin e strategjive alternative të komunikimit, me synim rritjen e besimit të publikut tek drejtësia. ENCJ në këtë raport zhvillon gjerësisht perspektivën e komunikimit në fushën e drejtësisë dhe sugjeron miratimin e planeve kombëtare të veprimit, kontrole periodike të nivelit të besimit, të trajnimeve profesionale specifike (për kryetarët e gjykatave, drejtuesit e prokurorive, gjyqtarët, prokurorët, stafin administrativ), zhvillimin e udhëzimeve për marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe medias. Veçanërisht, ndër të tjera rekomandon emërimin si “zëdhënës” të gjyqtarëve apo prokurorëve me specifikim trajnimit e komunikimit dhe ngritjen e një “departamenti të specializuar” që punëson profesionistë në komunikim nën drejtimin e “gjyqtarit/prokurorit të shtypit”.

Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) gjithashtu ka specifikuar se rëndësia publike e çështjes nuk mund të eliminojë/zerojë mbrojtjen e jetës private, që i përket individëve. Sipas praktikës së GJEDNJ, për sa i përket publikimit të paligjshëm të informacioneve (lajme sekrete ose konfidenciale, informacione të fushës rreptësisht private), ekziston një detyrë shtetërore për të marrë masa organizative dhe të trajnimit të personelit për të parandaluar rrezikun e publikimit të informacionit.

---

<sup>4</sup> Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare:

Rec (2010) 12, “Gjyqtarët: pavarësia, efektiviteti dhe përgjegjësia”; Rec (2011) 7

në lidhje me një nocion të ri të medias;

- mendimet e Këshillit Këshillimor të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE): n. 7 (2005), “Drejtësia dhe shoqëria”;

“Magna Karta e Gjyqtarëve (Parimet Themelore)” (2010); n. 14 (2011), “Drejtësia dhe teknologjitë e informacionit (TI) ”;

- opinionin i përbashkët CCJE-CCPE, “Deklarata e Bordosë” (2009), me titull “Gjyqtarët dhe magjistratët e prokurorisë në një shoqëri demokratike”, ku ndër të tjera përfshihet parimi, sipas të cilit “është në interes të shoqërisë që media mund të informojë publikun për funksionimin e sistemit gjyqësor” ndaj “gjyqtarët dhe prokurorët duhet të hartojnë një kod praktikash të mira ose udhëzime për secilin profesion në marrëdhëniet me median ”

Udhëzuesi inkurajon qasjen *proaktive, por edhe format reaktive të komunikimit* të Gjyqësorit ndaj Meidas dhe Publikut për garantimin e informacionit, në mënyrë që veprimtaria e gjyqësorit të jetë sa më transparente. Udhëzuesi merr përsipër të orientojë praktikën e komunikimit publik për korrigjimin ose përgënjeshttrimin e informacioneve të pasakta që mund të dëmtojnë hetimet, të drejtat personave, procesin e rregullt gjyqësor ose imazhin publik të gjyqtarit/gjykatës<sup>5</sup>.

Ky Udhëzues vjen si rezultat i ndërveprimit të shtuar të KLGJ me Programet e Asistencës së huaj dhe aktorët vendas në sektorin e shoqërisë civile. Misioni EURALIUS filloi punën në vitin 2020 për draftimin e një manuali që do të rregullonte mardhëniet e gjykatave me Median. Drafti mbante parasysh praktikën më të mira në Shtetet Anëtare të BE-së/acquis-së së BE-së / të drejtën europiane dhe ndërkombëtare/praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së/ose standarde të tjera referimi.

Në vitin 2021, KLGJ nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Qendrën për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP për koordinimin e përpjekjeve në përmirësimin e komunikimit të gjyqësorit me publikun dhe median përmes forcimit të rolit të Gjyqtarëve të Medias dhe nëpunësve gjyqësorë të përfshirë në marrëdhëniet me median dhe publikun. Pjesë e angazhimit dy-palësh është rritja e kapaciteteve të gjyqësor për të ndërvepruar cilësisht me median në funksion të informimit të publikut.

Finalizmi i këtij Udhëzuesi është bërë në kuadër të programit “Open Courts through Press Judges”, që INFOCIP po zbaton në bashkëpunim me KLGJ, me mbështetjen e Ambasadës Holandeze në Tiranë. Dokumenti ka konsultuar gjerësisht praktikën e konsoliduar holandeze në mardhëniet media gjyqësor. Kjo praktike është diskutuar gjerësisht me autoritetet e KLGJ dhe me gjyqtarët shqiptarë të medias në dy tryeza kombëtare të zhvilluara për këtë qëllim, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve të mirënjohur holandezë të medias të sjellë në Tiranë përmes Qendrës për Trajnime dhe Studime të Gjyqësorit në Holandë (njohur shkurt si SSR).

Për hartimin e këtij dokumenti është bërë një vlerësim koherent i përvojës shqiptare përmes takimeve në fokus-grupe me gjyqtarë të medias. Për të konsoliduar Udhëzuesin, është kërkuar edhe asistencë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtës për Informim.

---

<sup>5</sup> Neni 87 I ligjit 115/2016, parashikon në mënyrë eksplicite se: “Këshilli, me nismë ose bazuar në kërkesat e gjyqtarëve, mund të bëjë deklarata publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë kur gjykon se të drejtat e tyre njerëzore rrezikohen të shkelen për shkak të kryerjes së detyrës, ose se kryerja e funksioneve të tyre ligjore po rrezikohet ose mund të rrezikohet si rezultat i veprimeve ose qëndrimeve të çdo subjekti publik ose privat.”.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tirane, më \_\_.\_\_.2022

**PROJEKT UDHËZUES STANDARD I SHTYPIT**  
**Nr. \_\_ datë \_\_.\_\_.2022**

Në mbështetje të Neneve 22 dhe 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenit 91 , të Ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Neneve 46 dhe 50 të Ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", Neneve 103 dhe 104 të Kodit të Procedurës Penale, Neneve 2, 3, 7, 10, 14, 15 dhe 17 të ligjit "Për të drejtën e informimit", Neneve 2, 4, 6 pika 2, Nenit 18, Nenit 21, pika 3, e Nenit 28 i ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Ligji "Për arkivat" dhe praktikat më të mira europiane.<sup>6</sup>

**KAPITULLI I**

**DISPOZITA TE PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Synimi dhe objektivat**

1. Udhëzuesi për Marrdhëniet e Gjyqësorit me Median përcakton parimet e përgjithshme dhe rregullat konkrete për një proces efikas dhe korrekt të komunikimit të Gjykatave me mediat.
2. Udhëzuesi cakton modelin dhe objektivat në ofrimin e informacionit për Median dhe Publikun duke përcaktuar standartet e ndërveprimit.

---

<sup>6</sup> Shih Rekomandimet (Rec) 13 (2003) të 10 korrikut 2003 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës "Për sigurimin e informacionit përmes mediave lidhur me procedimet penale", Parimet 1-19;

- Rekomandimet (Rec) 12 (2010) e datës 17 nëntor 2010 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Për çështjet e pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së gjyqtarëve" - të cilat janë në interesin publik, paragrafi 19, i cili parashikon " trajtimin i administrimit të drejtësisë janë me interes publik.... Gjyqtarët duhet të ushtrojnë vetëpërbajtje në marrëdhëniet e tyre me median";

-Magna Karta e Gjyqtarëve, e miratuar më 17 nëntor 2010 nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) në paragrafin 14 (Qasja në drejtësi dhe transparencë) parashikon se "Drejtësia duhet të jetë transparente dhe informacioni mbi funksionin e sistemit gjyqësor duhet të publikohet."

- ENCJ (Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin), Raporti 2017-2018 "Besimi publik dhe imazhi i drejtësisë", miratuar në Lisbonë më 1 qershor 2018, rekomandon "... emërimin e" zëdhënësve ", gjyqtarëve ose prokurorëve me komunikim specifik trajnimin dhe krijimin e një "departamenti të specializuar" që punëson profesionistë të komunikimit nën drejtimin e "gjyqtarit/prokurorit të shtypit".

- Opinioni nr. 7, 2005, "Për Drejtësinë dhe Shoqërinë", Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë,

- Udhëzimet për video konferencat në proceset gjyqësore, miratuar nga CEPEJ-i në vitin 2021,

3. Komunikimi i gjykatave me median ofrohet nga shërbimet për marrëdhëniet me publikun sipas kompetencës që i njeh ligji specifik dhe duke respektuar kufizimet apo ndalimet e përcaktuara në ligjet procedurale.

## **Neni 2**

### **Parimet e ndërveprimit Gjyqësor -Media**

1. Marrëdhënia me median dhe qasja në informacionin që administrojnë gjykatat kryhen duke garantuar të drejtën e informimit<sup>7</sup>, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënat personale, reputacionin dhe prezumimin e pafajësisë.
2. Gjithçka që ndodh në një seancë gjyqësore është publike, nëse nuk përcaktohet ndryshe me ligj.
3. Seancat gjyqësore publike janë gjithmonë të hapura për gazetarët.
4. Komunikimi i Gjykatës me Median dhe përmes saj me publikun e gjerë duhet të jetë i besueshëm, transparent, objektiv, i paanshëm, i balancuar dhe i matur.
5. Të gjitha mediat trajtohen në mënyrë të barabartë, duke evituar diskriminimin e gazetarëve, dhënien e informacionit në mënyrë të personalizuar dhe favorizimin e mediave kombëtare ndaj atyre lokale.

## **Neni 3**

### **Kufizimet e komunikimit Gjyqësor Media**

1. Gjykata, në procesin e komunikimit me Median garanton mbrojtjen e jetës private dhe familjare (sidomos e të miturve) dhe dinjitetin (e viktimave, të personave vulnerabël, dëshmitarëve, të të pandehurit dhe familjarëve të tij, të të tretëve jashtë procesit).
2. Gjykata garanton në komunikim me Median parimin e procesit të drejtë dhe të drejtave të mbrojtjes; prezumimin e pafajësisë së personave që gjykohen prej saj, kufizimin e e dhënies së informacionit për çështjet që janë në fazën e hetimeve paraprake; të drejtat e viktimës së veprës penale; të drejtën e të pandehurit për të refuzuar komunikimin me median, fotografimin apo filmin prej saj.
3. Gjykata, në ndërveprim me Median merr masa për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve që gjykohen ose marrin shërbime në Gjykatë, konform legjisllacionit në fuqi.

---

<sup>7</sup> Në Shqipëri e Drejta për Informim është e drejtë kushtetuese. Neni 23, i kushtetutës përcakton se: "1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive."

4. Anonimizimi i të dhënave personale bëhet sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## KAPITULLI II Roli dhe funksionet

### Neni 4

#### Institucionet dhe personat përgjegjës

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucioni përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të Gjyqësorit me Median dhe publikun<sup>8</sup>. Këshilli cakton një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.
2. KLGJ miraton dhe përditëson, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, gazetarët dhe palë të tjera të interesuara Udhëzuesin Standard të Medias (USM).
3. KLGJ adopton Planin Strategjik të Komunikimit Gjyqësor, me parashikime konkrete për gjyqtarët e medias dhe rolin e tyre.
4. Gjykatat sigurojnë informimin cilësor të medias dhe përmes saj të publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, në respekt të parimit të publicitetit të seancës gjyqësore si dhe për çështje të tjera me interes mediatik, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
5. Personat që ndërveprojnë me Median në emër të gjykatës janë Gjyqtari i Medias (në gjykatat e apelit); nëpunësi civil gjyqësor i caktuar për marrëdhëniet me Median dhe Publikun, koordinatori për të drejtën e informimit.
6. Koordinatorin për të drejtën e Informimit, në rast se i është dhënë si funksion një personi tjetër nga Nëpunësi për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP), ka detyrimin të hartojë, mirëmbajë dhe përditësojë programin e transparencës, i cili behet publik në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. Funksionet e koordinatorit përcoktohen me ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

### Neni 5

#### Gjyqtari për Mediat

---

<sup>8</sup> Ligji 115/2016, “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, Neni 91 “Qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun

1. Gjyqtari për mediat (GJM) është gjyqtari në juridiksion apeli që Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka caktuar për të përmbushur detyrat e komunikimit të veprimtarisë gjyqësore me mediat<sup>9</sup>.
2. GJM duhet të ketë njohuri dhe aftësi për komunikim publik, të jetë i disponueshëm, rigoroz, i kujdesshëm dhe i matur.
3. GJM ndërvepron me Këshillin e Lartë Gjyqësor, drejtëpërdrejt por edhe nëpërmjet anëtarit të Këshillit përgjegjës për mediat, për avancimin e marrëdhënieve me mediat, në respekt të interesit publik dhe në mbrojtje të interesit të gjykatës.
4. GJM përfaqëson zyrtarisht institucionin në ndërveprim me gazetarët si dhe në daljet para medias për komunikimin e mesazheve të gjykatës që ai/ajo përfaqëson.
5. GJM merr masat që, brenda kufijve të detyrës, të ruajë nga presioni mediatik aktorët e procesit gjyqësor, në veçanti gjyqtarët, duke siguruar funksionimin e rregullt të veprimtarisë gjyqësore.
6. GJM reagon në emër të Institucionit në rast të konstatimit të informacioneve të pasakta që mund të qarkullojnë në media mbi veprimatrinë e gjykatës/juridiksionit që përfaqëson.
7. GJM vlerëson rastet për reagimin në media brenda funksionit që i është besuar si dhe përcakton mënyrën dhe masën e reagimit ndaj ngjarjeve të veçanta për të cilat Gjykata zgjedh të komunikojë me median. Deklaratat dhe intervistat e mundshme të GJM duhet të jenë të ekuilibruara, me sens mase dhe vetëpërmbajtje.
8. GJM siguron komunikimi zyrtar për median para, gjatë dhe në fund të proceseve gjyqësore që kanë interes të veçantë për publikun.
9. GJM faciliton përmes udhëzimeve praktike pjesëmarrjen e mediave/gazetarëve në seancat gjyqësore që përfaqësojnë interes për ta.
10. Udhëzon me gojë ose me shkrim NMMP për procedurat e dhënies së informacionit apo të komunikimit me mediat, nëse nuk ushtrohen drejtëpërdrejt prej tij.
11. Mbikqyr procedurën e akreditimit të shtypit/mediave për qasjen në gjykatat nën juridiksion për pasqyrimin e veprimtarisë gjyqësore dhe orientin ndërveprimin me Median në respekt të këtij Udhëzuesi.

## **Neni 6**

### **Nëpunësi për Mardhënie me Median dhe Publikun**

1. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me median dhe publikun (NMMP). Si rregull, NMMP mban edhe funksionin e koordinatori për të drejtën e Informimit .

---

<sup>9</sup> Po aty, Neni 91, paragrafi 3 “Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli”.



2. NMMP është burimi kryesor i informacionit që i përcillet mediave nga gjykata dhe është pika e kontaktit të gazetarëve për informacionet që këta të fundit i kërkojnë gjykatës. (të konsiderohet ky përcaktim, G.SH)
3. NMMP është personi përgjegjës për njoftimin e medias sa herë që kjo kërkohet nga Gjykata ose nga Gjyqtari i Medias.
4. NMMP bashkëpunon me personelit IT të gjykatës që faqja e internetit të gjykatës të ofrojë akses për publikun dhe median, kategoritë në faqe të jenë të populluar me informacion të përditësuar si dhe të publikojnë në kohë dhe me cilësi informacionet që ai/ako përcjell për publikim.
5. NMMP është personi përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e platformave në mediat sociale në të cilat gjykata publikon informacion zyrtar. Postimet në mediat sociale për llogari të gjykatës së apelit në çdo rast autorizohen nga Gjyqtari për Mediat.
6. (E hapur për inpute nga partnerët).

## Neni 7

### Koordinatori për të drejtën e informimit

( e hapur per inpute nga Komisioneri dhe partneret)

1. Koordinatorin për të drejtën e informimit, për qëllim të efektshmërisë së strategjisë së komunikimit të veprimtarisë gjyqësore:
  - a) Realizon, nën mbikqyrjen apo udhëzimin e gjyqtarit për mediat, komunikimin e veprimtarisë gjyqësore tek mediat dhe ndihmon në ruajtjen dhe përmirësimin e imazhit të gjykatës duke përzgjedhur sipas rëndësisë për publikun, përpunuar dhe paraqitur informacionin gjyqësor që do të publikohet në mediat publike.
  - b) Informon në mënyrë sistematike gjyqtarin për mediat për interesin që mediat paraqesin mbi një çështje gjyqësore të caktuar.
  - c) Organizon, sipas udhëzimeve të gjyqtarit për mediat, takime të shpeshta me mediat, veçanërisht në muajt shtator-janar për një përmbledhje se çfarë është kryer dhe do të kryhet gjatë këtyre muajve. Këto takime mund të jenë media për media, pra individuale, ose me të gjitha mediat së bashku.
  - d) I siguron medias, me kërkesën e tyre, informacionin mbi/për procedurat gjyqësore.
  - e) Siguron që të japë informacione objektive, që janë gjyqësisht dhe faktikisht të sakta, në një kohë të pandarë, në funksion të orareve të çdo media.
  - f) Siguron marrëdhënie proaktive me median, duke i dhënë informacion për veprimtarinë gjyqësore të rëndësishëm dhe domethënës për interesin publik,

duke ruajtur ekuilibrin midis respektimit të sekretit të hetimit dhe të drejtës së informimit/informacionit.

g) I transmeton gazetarëve të akredituar çdo informacion të vlefshëm, dhe veçanërisht:

h) identitetin e gjyqtarëve që përbëjnë trupin e gjykimit;

i) identitetin e prokurorit, si përfaqësues i organit të akuzës;

j) kalendarin e gjykimeve;

k) Identitetin e subjekteve të posaçme të gjykimit dhe akuzat që iu ngarkohen;

l) identitetin e subjekteve të posaçme në konflikt administrativ dhe objektin e mosmarrëveshjes; informacione gjyqësore mbi procedurën e ndjekur që lejon të kuptohet zhvillimi i procesit.

m) përpilon listën e gazetarëve të akredituar, kur është rasti duke e përditësuar në kohë reale, dhe ia transmeton përgjegjësve të shërbimeve të sigurimit.

n) vë në dijeni sigurimin e sallës së gjykimit që një gazetar i pakredituar është i lirë të hyjë nëqoftëse ka vend për t'u ulur në sallë

## KAPITULLI IV

### Shërbimi për gazetarët / Median

#### Neni 8

#### Informim para seancës gjyqësore

1. Gjykata përmes GJM dhe NMMP, në bashkërendim me stafin teknik që mirëmban sistemet online të gjykatës, i sigurojnë gazetarëve informacione në lidhje me çështjet e ardhshme dhe ato që janë në vazhdim.
2. Gjykata vendos në dispozicion të gazetarëve pa pagesë listën e seancave gjyqësore. Kalendarin e seancave gjyqësore rekomandohet të jetë rubrike me informacion proaktiv në faqen zyrtare të internetit e cila përditësohet nga gjykata me bazë javore.
3. Komunikimet në lidhje me rrjedhën e hetimeve penale paraprake janë përgjegjësi e prokurorisë. Gjykata është përgjegjëse për dhënien e informacionit në lidhje me të pandehurit që paraqiten para gjyqtarit dhe vendimet që janë marrë nga gjykata.
4. Gjykata mund të bëjë njoftime në lidhje me çështjet që trajtohen për paraburgimin, për shembull nëse gazetarët tashmë janë në dijeni të çështjes ose emrin e të pandehurit dhe/ose faktin se duhet të merret vendim lidhur me paraburgimin.
5. Gjykata mund të bëjë njoftime për shtyp për çështjet që gjykohen me dyer të mbyllura në procedurat lidhur me ndjekjen penale ose ndjekjen penale të

mëtejshme (për shembull nëse gazetarët tashmë janë në dijeni të emrin e të pandehurit dhe/ose faktin që gjykata në seancë të mbyllur duhet të vendosë për këto çështje).

## **Neni 9**

### **Pjesëmarja në Seancën Gjyqësore**

1. Seancat gjyqësore publike janë gjithmonë të hapura për gazetarët.
2. Gjatë seancës, gazetarët lejohen të dërgojnë mesazhe përmes telefonit të tyre celular dhe/ose laptopit. Tingulli duhet të fiket në pajisje të tilla (të jenë pa zë).
3. Gjyqtari mund të kufizojë ose të ndalojë dërgimin e mesazheve me celular/laptop gjatë seancës, për shembull nëse dërgimi i mesazheve pengon administrimin e duhur të drejtësisë ose rendin e rregullt të procedurës. Gjyqtari duhet të arsyetojë vendimin e tij ose të saj për të kufizuar ose ndaluar dërgimin e mesazheve në publik gjatë seancës.
4. Në gjykata nuk mund të bëhen regjistrime audio-vizuale pa leje. Gazetarët që dëshirojnë të bëjnë regjistrime të tilla duhet të kontaktojnë paraprakisht GJM dhe/ose NMMP.
5. Fotografëve do t'u jepet mundësi për të bërë fotografi përpara seancës dëgjimore ose në kohën e rënë dakord me GJM ose NMMP. Gjyqtari kryesues i seancës mund të vendosë të një kohë tjetër të përshtatshme për të lejuar bërjen e fotove në sallën e gjyqit.
6. Me qëllim që seanca gjyqësore të ketë rrjedhën e duhur, imazhet duhet të regjistrohen/merren nga një pozicion fiks.
7. Për të siguruar rendin e duhur të procedurës, gjykata mund të vendosë që t'i lejohej aksesin një numri të kufizuar ekipesh me kamera dhe të përcaktojë si kusht që ata të jenë pjesë në një skemë shpërndarjeje tek të tjerët (që nuk kanë akses).

## **Neni 10**

### **Seancat gjyqësore për çështjet penale**

1. Gjatë seancave penale, gazetarët në çdo rast mund të bëjnë regjistrime audio-vizuale të mbërritjes së gjyqtarëve, hapjes së seancës nga kryetari i trupës gjyqësore, paraqitjes së akuzave, trajtimit të fakteve, konkluzioneve të prokurorit, deklaratave të të pandehurve nëse e quajnë veten fajtor ose jo për veprën penale, replikat dhe kundër-replikat dhe shpalljes së vendimit gjyqësor, përveç rasteve kur ka rrethana të jashtëzakonshme.

2. Gazetarët mund të paraqesin kërkesa për t'u lejuar të bëjnë regjistrime të pjesëve të tjera të seancës penale.
3. Gjatë seancës mund të bëhen regjistrime audio-vizuale të personave që marrin pjesë në seancë për shkak të detyrës
4. Nuk lejohet të bëhen regjistrime vizuale dhe/ose audio të dëshmitarëve, ekspertëve, viktimave apo publikut. Gazetarët mund t'u kërkojnë këtyre personave personalisht leje për të bërë regjistrime audio-vizuale. Në rrethana të jashtëzakonshme, gjyqtari mund të ndalojë bërjen e regjistrimeve të tilla, duke disponuar me vendim të ndërmjetëm, i cili, nëse është me shkrim, duhet të arsyetohet (shkurtimisht).
5. Nuk lejohet t'i kërkojë të pandehurit leje për të marrë imazhe vizive. Zëri i tij/i saj mund të regjistrohet. Në rast se i pandehuri kundërshton regjistrimin e zërit të tij, gjyqtari mund të ndalojë regjistrimin e zërit të pandehurit ose mund të vendosë që zëri i të pandehurit të modifikohet me program audio (distorted).

## **Neni 11**

### **Seancat gjyqësore për çështjet civile**

1. Gazetarët mund të bëjnë regjistrime audio-vizive të të gjithë seancës, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.
2. Gjatë seancës mund të bëhen regjistrime audio-vizive të personave që marrin pjesë për shkak të detyrës në procesin gjyqësor.
3. Nuk lejohet të bëhen regjistrime audio-video të palëve në proces gjyqësor pa lejen e tyre. Gazetarët mund t'u kërkojnë palëve personalisht leje për të bërë regjistrime vizive dhe audio. Megjithatë në rrethana të jashtëzakonshme gjyqtari mund të ndalojë bërjen e regjistrimeve vizive dhe audio të atyre që nuk marrin pjesë për shkak të punës.
4. Gazetarët mund të bëjnë kërkesë gjyqtarit që kryeson seancën për të transmetuar drejtpërdrejt të gjithë ose një pjesë të seancës.
5. Gjyqtari duhet të arsyetojë vendimin e tij/ të saj në rast se ai/ ajo refuzon një kërkesë për të bërë regjistrime audio-vizive të pjesëve të seancës dhe/ose për të bërë transmetim të drejtpërdrejtë. Në këtë rast, gjyqtari duhet të peshojë interesin e aksesit publik kundrejt interesave të tilla si më poshtë vijon:
  - regjistrimi video dhe audio nuk duhet të jetë pengesë për administrimin e duhur të drejtësisë (p.sh. përcaktimi i së vërtetës); privatësia e pjesëmarrësve në procedurë duhet të ruhet;
  - procedimi i rregullt i seancës duhet të garantohet në mënyrë e duhur;
  - aspektet e sigurisë duhet të zbatohen siç duhet.

6. Fragmentet zanore ku mund të dëgjohen emrat duhet të modifikohen, për shembull duke i fshirë emrat ose duke i zëvendësuar me një sinjal audio.
7. Gazetarët mund të bëjnë regjistrime jashtë sallës së gjyqit në ambientet e gjykatës që janë caktuar për këtë qëllim.

#### **Neni 12**

##### **Seancat gjyqësore për çështjet administrative**

1. Seancat gjyqësore administrative janë gjithmonë të hapura për gazetarët dhe publikun e interesuar.
2. (e hapur...te shtohen inpute nga partneret)

#### **Neni 13**

##### **Akses i veçantë i gazetarëve në një seancë me dyer të mbyllura**

##### **(e hapur per inpute nga partneret, vendos KLGJ)**

1. Në disa raste gjyqtarit i lejohet me ligj t'u japë palëve të treta akses të veçantë në seancat e mbyllura. Gjithashtu, gazetarët kanë të drejtë t'i paraqesin GJM ose NMMP kërkesë të argumentuar për akses të veçantë në një seancë të mbyllur.
2. Nëse jepet akses i veçantë, Gjyqtari shprehet me vendim se cilat pjesë të seancës mund të mbulohen edhe mediatikisht. Në këtë rast gjyqtari përcakton formën dhe mjetet e regjistrimit që mund të përdoren nga gazetari. Gjyqtari mund të vendosë që gazetari të ndjekë seancën thjesht duke mbajtur shënime, pa e regjistruar atë me mjetet që regjistrjnë zërin dhe imazhin.
3. Gazetarëve të cilëve u është dhënë akses i veçantë për të ndjekur një seancë të mbyllur mund t'u kërkohet të nënshkruajnë një protokoll që përmban udhëzime shtesë ku gazetari angazhohet për respektimin e urdhërimeve të këtij neni.

#### **Neni 14**

##### **Informacion për vendimet gjyqësore**

1. Gjykata duhet të publikojë vendimin e saj dhe arsyetimin sa më shpejt të jetë e mundur në faqen zyrtare të internetit. Vendimet gjyqësore publikohen si rregull të anonimizuara.

2. Pas përfundimit të procesit gjyqësor, gjykatat mund të publikojnë në faqen e saj zyrtare në internet edhe vendimet e ndërmjetme të çështjes së gjykuar, në format të anonimizuar (pa emra), në rastet kur ka një interes të veçantë nga media.
3. Vendimet në dhomë këshillimi??? (e hapur për ipute nga partnerët)
4. Vendimet e paarsyetuara..???
5. Gjykata do t'u japë gazetarëve një kopje fizike të vendimit të anonimizuar të vendimit pasi të jetë depozituar më parë një kërkesë për informim për ta disponuar vendimin gjyqësor në format në letër (hard-copy).

**Komisioneri ti kërkohet opinionin i kualifikuar mbi parashikimet e këtij neni**

## Neni 15

### Menyrat e komunikimit me median

1. Gjyqtari i Medias në juridiksionet e apelit është personi kyç që realizon komunikimin e Gjykatës me Median. Në rastin e gjykatave të shkallëve të tjera, NMMP në bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës (ose Këshillin) merr përsipër përgjegjësinë e komunikimit mediatik, kur kjo konsiderohet e domosdoshme.
2. Komunikimi i Gjykatës me Median është i përcaktuar përmbajtje dhe në formë. Përmbajtja mban parasysh kriterin e objektivitetit, balancës dhe vetë-përmbajtjes, në përputhje me parashikimet e nenit 2 dhe 3 të këtij Udhëzuesi
3. Format tradicionale të komunikimit të gjykatës me median janë:
  - a) Njoftimi për media (komunikatë për shtyp)
  - b) Konferencë për media
  - c) Intervista
  - d) Përgjigje me shkrim për pyetjet me shkrim
  - e) deklarata zyrtare ose publikim informacioni që lidhet me punë e gjykatës në faqet zyrtare të internetit të gjykatës (analiza vjetore, vlerësime tematike, masa disiplinore, vendime të arsyetuara ose përmbledhje periodike vendimesh, sipas tematikës ose rendit kalendarik, etj)
  - f) Debate televizive (më median audio-vizuale)
  - g) Mesazhet e filmuara – video mesazhe për të komunikuar një shërbim të ri, ose një kufizim në dhënien e shërbimeve të gjykatës, etj)
4. Format bashkëkohore të komunikimit përfshijnë ndërveprimin e Gjykatave direkt me publikun përmes faqes zyrtare në internet të gjykatës dhe rrjeteve sociale.
  - a) Faqja zyrtare në internet e gjykatës përmban informacion për gjykatën, trupën gjyqësore dhe trupën civile, njoftime, program transparence, legjislacion të dobishëm, listën e shërbimeve, tarifatat gjyqësore, kontaktet e

*gjqtarit të medias, NMMP, koordinatorit për të drejtën e informimit, informacion mbi strukturën gjyqësore, juridiksionin civil-penal, ndihmën juridike dhe mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrveshjeve, etj.*

- b) *Gjykatat mund të kenë një faqe zyrtare në rrjetet sociale (FB ose Tëitër). Media sociale përcjell informacion të dobishëm direkt tek publiku, pa rrezikun e keqpërdorimit të përmbajtjes nga gazetarët/media. Çdo informacion që hidhet në faqen zyrtare të internetit mund të publikohet në vesion të shkurtuar (ose jo) edhe në faqen zyrtare që ka gjykata në rrjetet sociale.*

## **Neni 16**

### **Komunikimi ne situata me ndjeshmëri mediatike/publike**

1. Ngjarjet në gjykatë nganjëherë ndodhin në mënyrë të papritur dhe tërheqin interesim të madh mediatik. Situatat të tilla mund të kërkojnë komunikim të shpejtë dhe adekuat nga Gjyqtari për Mediat janë:
  - a) Ngjarje **me ndjeshmëri të lartë publike;**
  - b) Publikimi i informacionit të pasaktë për çështjet në proces (në raste të veçanta kur ky publikim përbën një kërcënim të menjëhershëm për funksionimin ose reputacionin e një institucioni gjyqësor, për shembull për shkak të shpërndarjes shumë të gjerë të informacionit të rremë në mediat online);
  - c) Sulmet publike kundër gjykatës në përgjithësi;
  - d) Sulmet publike ndaj gjyqtarëve;
  - e) Gabimet e vërtetuara të autoritetit gjyqësor në menaxhimin e çështjeve;
2. Sipas situatave specifike, komunikimi me Median synon :
  - a) Të informojë për situatën aktuale dhe veprimet e miratuara;
  - b) Të sigurojë ose të paralajmërojë publikun;
  - c) Të korrigjojë dhe rregullojë informacionin e pasaktë;
  - d) Të rivendosë faktet dhe të shpjegojë rrethanat ligjore;
  - e) Të ruajë ose rikthejë besimin tek autoriteti gjyqësor;
  - f) Të ruajë ose rikthejë reputacionin e gjyqtarëve;
  - g) T'i përgjigjet sulmeve.

## **Neni 17 (te ridiskutohen me Valbonen)**

### **Ndalimi i regjistrimit, transmetimit ose shpërndarjes së seancave gjyqësore**

1. **Seancat gjyqësore mund të regjistrohen dhe transmetohen në media me kërkesë të mediave ose me iniciativën e trupit gjykues. Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi**

- i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.
2. Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë, tërësisht ose pjesërisht, me urdhër të trupit gjykues, i cili gjykon për çështjen e gjykimit.
  3. Trupa gjyqësore ka të drejtën të:
    - a) lejojë ose të ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës;
    - b) lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesëshëm të seancës;
    - c) Të ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore që ishte lejuar më parë të regjistrohej;
  4. Regjistrimi audiovizual në sallën e gjyqit bëhet vetëm nga operatorët e radiotelevizionit me lejen e trupit gjykues dhe çdo regjistrim tjetër është i ndaluar.
  5. Sekretariati, kur ka të dhëna se një çështje është me interes të madh për publikun ose kur ka kërkesë nga media e transmetimit të drejtpërdrejtë, njofton panelin e gjyqtarëve për këto çështje.
  6. Të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve në Gjykatë:
    - a) Gazetarët, pa praninë e kamerave dhe mjeteve të regjistrimit, lejohen të ndjekin seancat e hapura gjyqësore pa asnjë pengesë;
    - b) Përjashtimisht, kufizimet mund të vendosen në rastet kur salla e gjyqit nuk është mjaft e madhe për të akomoduar të gjithë të interesuarit për të marrë pjesë në seancë;
    - c) Gazetarët janë të detyruar të ndjekin procesin gjyqësor pa komente dhe brenda rregullave që lidhen me një gjykim të drejtë;
    - d) Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen për gazetarët dhe punonjësit e radiotelevizionit;
    - e) Shkelja e rregullave gjatë procesit gjyqësor, me vendim të trupit gjykues, dënohet administrativisht me gjobë ose me largim nga salla e gjyqit referuar dispozitave ligjore në fuqi;
    - f) Regjistrimet dhe transmetimet e kryera në fshehtësi dhe pa miratimin e trupit gjykues i nënshtrohen dispozitave ligjore të legjislacionit në fuqi.

## **Neni 18**

### **Aksesi publik në dokumentet dhe informacionet e gjykatës**

1. Në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, parimet e përgjithshme në lidhje me aksesin në dokumentet zyrtare të gjykatës dhe informacionet e mbajtura nga gjykata janë si më poshtë vijon:



- a) Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik që administrohet nga gjykata pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- b) Autoriteti publik (gjykata) është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
- c) Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
- d) Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Audio jepet.....

### Neni 19

#### Dokumentat me akses publik

1. Publiku do të ketë akses të pakufizuar në:
  - a) Arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe informacionin për vendimet gjyqësore që i referohen Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili përcakton kushtet dhe kriteret e përjashtimit nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime publicistike, letrare apo artistike (të të gjitha niveleve).
  - b) Përmbledhjet e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë.
  - c) Informacionin e përgjithshëm mbi paditë, palët në gjykim, kërkesat për gjykim, datat e gjykimit dhe çështjet e gjykimit, llojin e çështjes, bazën ligjore, gjyqtarin e çështjes, datën dhe orën e seancës gjyqësore.
  - d) Informacionin statistikor nga gjykata, përfshirë numratorët e regjistrimit të çështjeve gjyqësore.
  - e) Informacionin mbi statusin e gjykimit të çështjes dhe përfundimin e saj (faza e gjykimit, përfshirë apelimin).
  - f) Raportet/analizat vjetore të gjykatës.
  - g) Të dhënat për shpenzimet gjyqësore dhe buxhetet.
  - h) Të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli i Gjykatës.

### Neni 20

#### Të dhënat personale në Gjykatë

**Cfare nuk jepet....(përcaktim nga partneret dhe nga Komisioneri)**

## KAPITULLI V ZBATIMI

### **Neni 21** **Zbatimi**

1. Gjyqtari për mediat dhe Nëpunësi gjyqësor për Median dhe Publikun për zbatimin e këtij Udhëzuesi/Udhëzimi.
2. Gazetarët të cilët kanë ankesa për mënyrën e zbatimit të neneve të këtij Udhëzuesi mund të kontaktojnë me Gjyqtarin e Median të gjykatës në fjalë për të ballafaquar pretendimet e tyre.
3. Gjykata është përgjegjëse për të garantuar që marrëveshjet e bëra me gazetarët të respektohen. Në rast se një gazetar nuk respekton marrëveshje, drejtuesit e gjykatës mund të marrin masa sanksionuese. Në këto raste merret parasysh natyra e shkeljes, frekuenca dhe pasojat specifike. Drejtuesit e gjykatës mund të japin thjesht një paralajmërim, ose mund vendosin çrregjistrimi nga lista e akreditimit. Gjykatat e tjera dhe Këshilli i Lartë do të vihen në dijeni për masat e marra.

## Shtojca 1

### I. Komunikata për mediat

1. Komunikimi për mediat (shtyp) përdoret për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore.
2. Komunikimi për mediat (shtyp) është një burim zyrtar informacioni. Teksti përpilohet me kujdes nga shërbimet me marrëdhënien për publikun dhe hartohet me një gjuhë të kuptueshme nga të gjithë, mundësisht pa ngarkesa me terma procedural apo teknikë. Teksti përpilohet në formën e një njoftimi me disa paragrafë (max. 5-6)
3. Komunikimi për mediat (shtyp) shpërndahet kryesisht me email. Për këtë është e nevojshme që Gjykata të disponojë më parë një listë (address-book) me adresat e mediave në të cilat shpërndahet njoftimi për shtyp (komunikata).
4. Nëpunësi për Marrdhëniert me Median dhe Publikun publikon njoftimin për shtyp edhe faqen zyrtare të gjykatës, në një kategori të posaçme që aksesohet në faqen kryesore (home).
5. Njoftimi për shtyp (komunikata), përveç tekstit bazë, duhet gjithmonë të përmbajë: logon e gjykatës, emrin e gjykatës, datën, titullin 'Komunikim për shtyp' ose "njoftim për shtyp" dhe të dhëat e personin të kontaktit.
6. Komunikimi për shtyp shërben për t'i përcilljellë medias dhe publikut informacion për:
  - a) vendimet gjyqësore të veçanta apo përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;
  - b) rolet respektive të aktorëve në sistemin e Drejtësisë ;
  - c) për veprimtarinë gjyqësore sidomos në lidhje me çështjet në gjykim;
  - d) masat e sigurimit, pa cënuar sekretin hetimor ;
  - e) përgënjeshttrimin ose saktësimin e informacioneve të gabuara dhe/ose të jo-korrekte.
10. Modele të deklaratës për shtyp ofrohen si pjesë e këtij Udhëzimi.

## II. Konferenca për shtyp

1. Konferenca për media (shtyp) është një event i organizuar nga Gjykata për të shpërndarë zyrtarisht informacion për publikun përmes medias, duke iu përgjigjur edhe pyetjeve të kesaj të fundit. Konferenca për shtyp synon:
  - a) Të përcjellë një mesazh zyrtar për të gjitha mediat;
  - b) Të lejojë shtypin audiovizual të kapi zërin dhe imazhin;
  - c) Të lejojë ndërkomunikimin, falë ndërveprimit pyetje-përgjigjeve.
2. Kur Gjykata vendos të organizojë një konferencë për mediat (shtyp), Nëpunësi për marrdhëniet me Median dhe Publikun njofton të gjitha mediat për orën, vendin dhe temën e konferencës për shtyp.
3. Njoftimi për mbajtjen e konferencës për shtyp si rregull shpërndahet 24 orë përpara zhvillimit të eventit. Njoftimi zyrtar shpërndahet me email zyrtar. NMMP mund të përdorë për shpërndarjen e njoftimit edhe rrjetet sociale (FB ose rrjete të tjera sociale që përdoren zyrtarisht nga gjykata si kanale komunikimi me publikun e interesuar). Po ashtu, NMMP mund të përforcojë marrjen/shpërndarjen e njoftimi për mbajtjen e konferencës për media (shtyp) edhe përmes rrjeteve të shpejta të komunikimit si Ëhatsup.
4. Konferenca për mediat (shtyp) si rregull mbahet nga Gyqtari i Medias, për/në juridiksionet e apelev në të cilat ai/ajo është caktuar të punojë. Konferenca fillon si rregull me leximin e një deklarate përpra medias së pranishme nga gjyqtari për mediat dhe më pas vijon me pyetje dhe përgjigje me gazetarët.
5. Për të organizuar një konferencë për media (shtyp) të sukseshme dhe mbi të gjitha, brenda formatit zyrtar të komunikimit, merren parasysh kriteret e mëposhtme:
6. Barazia e mediave: gazetarët e interesuar kanë qasje të njëkohshme në informacion (të paktën për ata që kanë mundësi të dërgojnë një gazetar në konferencën për shtyp).
7. Uniformiteti i informacionit të dhënë: çdo pjesëmarrës merr të njëjtin informacion.
8. Ndërveprimi verbal aktiv me marrësit e informacionit (gazetarët) duke iu dhënë mundësinë të gjithëve të drejtojnë pyetje dhe të marrin përgjigje.
9. Respekt ndaj medias së pranishme dhe ndaj publikut që përmes gazetarëve merr informacionin që gjykatë dëshiron të përçojë.
10. Vlerësim sipas rastit i nevojës për të korrigjuar përmes ndërveprimit me pyetje-përgjigje ndonjë keqkuptim apo pasaktësi që mund të përmbajë teksti i deklaratës së lexuar.

### III. Intervista

1. Intervistat janë forma ndërveprimi me median që lejojnë thellimin e argumentit për një çështje që ka interes publik. Intervistat mund të jenë të shkurtra (1-2 minuta) ose të gjata. Në rastin e parë ato përdoren për të plotësuar më informacion zyrtar një kronikë ose shkrim. Në rastin e dytë ato mund të përdoren nga Gjyqtari i Medias për të elaboruar qëndrimet e Gjykatës ose për të shpjeguar vendime gjyqësore të një rëndësie të veçantë.
2. Në parim çdo gjykatë bashkëpunon me ata që duan të bëjnë dokumentarë dhe intervista. Kërkesa për intervista që destinohen për dokumentarë (intervista të gjata) duhet të dorëzohen me shkrim ose me email zyrtar dhe koordinohen nga NMMP. Ky l fundit mund të kërkojë që gazetari të depozitojë me shkrim edhe pyetjet që ka përgatitur për GJM.
3. Intervista ne media mbart rrezikun e deklaratave që mund të dalin jashtë kontrollit nga an e gjyqtarit të medias. Intervistat live nuk janë një formë e këshillueshme në kuadër të mardhënieve Gjykatë – Media. Megjithatë, ato janë të domosdoshme në rastin kur synohet dhënie e një informacioni ku thellohet argumenti teknik, për të eliminuar shmangjen e gabimeve në interpretim nga Media apo adresimn e perceptimeve të gabuara nga Publiku.
4. Gjyqtari për mediat mund të kërkojë, si parakusht për intervistën, të kontrollojë më vonë deklaratat e regjistruasra përpara se ato të publikohen apo përdoren në kontekstin e një kronike televizive apo shkrimi në gazetë.
5. Një ndërhyrje televizive ose radio në përgjithësi nuk i kalon disa dhjetëra sekonda dhe prandaj subjekti që jep intervistën duhet të jetë konciz dhe i qartë. Intervista për botim në shtyp mund të trajtojë më gjerësisht pyetjet e bëra, por gjyqtari i medias duhet të jetë i parapërgatitur se në të vërtetë do të publikohen vetëm një pjesë e deklaratave të tij/saj. Përdorimi i "pikave" për strukturimin e përgjigjeve mund të prodhojë rezultate të mira.
6. Këshilla praktike për t`u mbajtur në konsideratë gjatë një seance intervistimi:
  - a) Ju po i drejtoheni një publiku të përgjithshëm por gjithashtu një gazetari, palëve, partënerëve institucional dhe kolegëve;
  - b) Përdorini fjalë/fjali të thjeshta, të kuptueshme nga të gjithë duke qëndruar gjyqësisht i drejtë;
  - c) Mos lexoni elementet e shkruajtura paraprakisht ;
  - d) Është normale nëse vëreni se gazetari riformulon në mënyrë të shumëfishtë pyetjen e tij.
  - e) Përgjigjuni qetësisht dhe me konfidencë
  - f) Mos shihni asnjëherë në kamera por gjithmonë gazetarin në sy ;

- g) Mos harroni që kamerat dhe mikrofonat mund të vazhdojnë të xhirojnë dhe që gazetarët vazhdojnë të kryejnë punën e tyre; Asnjëherë besimi nuk përjashton kujdesin!
- h) Është në interesin e përbashkët të Gjyqatrit për mediat aq edhe të gazetarit për të pasur një intervistë të mirë përfunduar.
- i) Në situatë interviste live, në rast vështirësie ose gabimi, mos hezitoni të rimerrni veten “për të saktësuar idenë tuaj”
- j) Gjyqatri për mediat, përgjatë intervistës, duhet të flasë me gjuhë të kujdesshme dhe të qetësuar

#### **IV. Përgjigje me shkrim për pyetjet me shkrim**

1. Për të marrë informacion, gazetarët mund të kontaktojnë gjyqtarin e medias, me shkrim, ose në rrugë elektronike me e-mail. Ky është veçanërisht rasti kur një gazetar synon të botojë një artikull analitik ose investigativ. Të marrësh pyetje me shkrim nga një gazetar mbi çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e gjykatës është një mënyrë komode për të ofruar përgjigje objektive, të arsyetuara dhe të përmbajtura në terma të informacionit me natyrë profesionale nga a e gjyqtarit të medias.
2. Gjyqtari për mediat iu përgjigjet, pyetjeve me shkrim. Nëse është e nevojshme, GJM mund të kërkojë të këshillohet me Kryetarin e Gjykatës apo nëse nevojitet, edhe me KLGJ.
3. Nëse gazetari ka kërkuar edhe dërgimin e një foto, kjo mbetet në të drejtën e GJM për të vlerësuar neës publikimi i përgjigjeve duhet të shoqërohet edhe me foton respektive. GJM përgjigjet zyrtarisht në emër të gjykatës dhe shoqërimi i përgjigjeve zyrtare me foton personale nuk është i domosdoshëm.
3. Gjyqtari për mediat ka të drejtë të mos përgjigjet për pyetjet që janë jashtë kompetencës apo juridiksionit të gjykatës ku ai/ajo punon. Në këtë rast, GJM mund të shënojë në këtë arsyetim (jashtë competence, apo jashtë juridiksioni) për mos-marrjen e pyetjes.
4. Gjyqtari i Medias mund të refuzojë dhënien e një përgjigjeve ndaj gazetarëve që nuk janë të akredituar nga Gjykata apo që kanë shkelur më herën normat që cakton Udhëzuesi për mediat.

#### **V. Debati mediatik (jo e rekomandueshme)**

1. Nëse Gjyqtari për mediat është i ftuar në një debat televiziv, me tematikë në fushën e Drejtësisë, përpara se të marrë pjesë në debat duhet të:
  - a) Kërkojë identitetin dhe funksionin e debatuesve të tjerë.

- b) Bëjë kërkime, veçanërisht falë siteve të kërkimit (Google...), mbi eksperiencën dhe pozicionimin e tyre.
- c) Dëgjojë ose vështrojë një emision paraardhës për të ditur tonin, mënyrën e zhvillimit, personalitetin e moderatorit të emisionit.
- d) Vlerësojë kohën e tij të fjalës duke llogaritur kohën e debatit/ debutues.
- e) Përcjellë mesazhin e tij në bazë të funksionit të medias dhe të natyrës së programit.

## 2. Gjatë debatit:

- a) Të mbajë parasysh që është vazhdimisht i filmuar, edhe kur nuk ka fjalën edhe kur bëhet fjalë për një debat radio.
- b) Si rregull i përgjithshëm, gazetari që i jep jetë debatit fikson rregullat duke nxitur ose duke ndaluar debatuesit që të presin fjalën njëri tjetrit.
- c) Në një debat afatgjatë – më shumë se 15 minuta – kohët e fjalës kanë tendencën që të ekuilibrohen vetë në mënyrë natyrale, nën kontrollin e moderatorit.
- d) Për debatet me kohë të shkurtër – më pak se 10-15 minuta – ritmi është domosdoshmërisht më dinamik, dhe koha kalon më shpejt, ndaj mos të hezitohet të marri fjalën pa qënë i ftuar.

## **VI. Mesazhet e filmuara**

- 1. Mesazhet e filmuara kanë për qëllim të informojnë publikun - ose pjesë të publikut - për veprimtarinë gjyqësore në përgjithësi ose për aspekte të veçanta të atij aktiviteti.
- 2. Shtypi i akredituar kërkon 3 ditë para gjykimit për të filmuar sekuenca nga veprimtaria gjyqësore, kërkesë që vlerësohet nga trupi gjyqësor dhe i komunikohet medias nga shërbimet e marrëdhënieve me publikun, si nëpërmjet rrugës elektronike ashtu edhe me shkresë. Nëse kërkesa nuk paraqitet në afatin e kërkuar nuk lejohet filmimi.

## **VII. Komunikimi përmes rrjeteve sociale.**

### **Inpute extra...**

## ANEKS 2

### Sugjerime për një konferencë për shtyp të suksesshme:

Vendndodhja: aksesueshmëria për një numër të madh të pranishmëve, përshtatshmëria e ambienteve me vëmendje të veçantë ndaj aftësisë, disponueshmëria e Ëi-Fi, aksesit në parking, etj.

Koha: në lidhje me median e shkruar, është e rëndësishme të merret parasysh se konferencat editoriale mbahen shpesh në mëngjes, si dhe të ruhen në konsideratë afatet për përgatitjen dhe botimin e artikujve. Duket se gazetarët preferojnë konferencat për shtyp në mëngjes, me përjashtim të urgjencave.

Folësi(ët): personi ose personat që kanë informacionin dhe autoritetin për të informuar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve me besueshmëri.

Subjekti/objekti: duhet të jetë interesant; Duhet të shmanget thirrja e një konference për arsye të vogla dhe të bëhen konferenca të tilla një rutinë e lodhshme.

Rregullime/përshtatje sipas rëndësisë së ngjarjes dhe mundësive praktike.

Organizimi: 'moderatori i ceremonive' që ua jep fjalën të tjerëve.

Shpërndarja e një përmbledhjeje me shkrim: është një mjet i preferuar në përgjithësi nga gazetarët që ndihmon në shmangien e keqkuptimeve.

Objekte për prezantim (p.sh.: droga e sekuestruar) ose fotografi (për objekte që nuk janë të disponueshme gjatë prezantimit).

Pyetje dhe sesioni i përgjigjeve: përgjigje të sinqerta për pyetjet edhe kur duhet të pranohet se nuk e dini përgjigjen ose kur është e pamundur të jepni një përgjigje; ofrimi i shpjegimeve, në këto raste.

Lini pak kohë për t'iu përgjigjur secilit gazetar: nevoja të veçanta të mediave të caktuara, radio ose TV. 'Ekskluziviteti' relativ, ose të paktën për të lënë përshtypjen te lexuesit/dëgjuesit/shikuesit se gazetari mori diçka të veçantë. Redaktorët do ta pëlqejnë atë.

Reagimi ndaj një konference për shtyp është përgjithësisht më i favorshëm kur gazetarët mendojnë se autoriteti gjyqësor nuk iu ka humbur kohën dhe se në vend të kësaj ky autoritet iu ka lehtësuar punën.

Përgatitja:



- Shkruani një përmbledhje të strukturuar e cila përmban pikat më të rëndësishme dhe strategjike të mesazhit që dëshironi të përcillni : Fjalët kyçe, shprehitë parësore ;
- Parashikoni të gjitha pyetjet që mund t'ju bëhen dhe parashikoni përgjigjet e përshtatshme ;
- Mos harroni që po i adresoheni mbi të gjitha një publiku të përgjithshëm por gjithashtu gazetarëve, palëve, partënerëve institucional dhe kolegëve ;
- Priviligjoni shprehitë e kuptueshme për të gjithë, duke qëndruar gjithmonë i drejtë.